



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-2470/24 datë: 22.01.2024



Npi – 01/49 datë: 29.01.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 29.01.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 29.01.2024 (e hënë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGGJ; z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; znj.Kimete Ukaj, nga ZKF; Nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, dhe znj.Gentiana Mehmeti. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.12.2023,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024,
3. Raport Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023,
4. Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik),
5. Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (për diskutim publik),
6. Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (për diskutim publik),
7. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit,
8. Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)
9. Propozim-Vendim për ndarjen e subvenc. për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024,
10. Propozim-Vendim për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes,
11. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.12.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

****Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26.12.2023.**

Pika 2

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Përshëndetje, fillimisht e potencoï bazën ligjore. LVL-në mbi bazën e të cilës jemi referuar për këtë rregullore. Materialin e keni marrë me kohë. Në vazhdim sqaroi nenin 8 të rregullores si dhe përmendi pikën 11.3 që ka të bëjë me pagesën për çerdhen e fëmijëve. Kjo rregullore ka me shku në diskutim publik.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem të shkojë në diskutim publik me propozimet.

z.Adelina Beqa; Përshëndetje, te Veteranët a është lirimi i paraparë vetëm për individin apo edhe për familjarët.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Vetëm për individin.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024.**

Pika 3

Raport Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Paraqiti raportin për vitin 2023. Përmendi bazën ligjore Ligji për financat publike dhe përgjegjësitë. Ne e kemi obligim ligjor që të paraqesim para Kuvendit raportin përfundimtar financiar për vitin 2023. Në vazhdim lexoi me shifra të dhënat sipas kategorive ekonomike (shih dokumentin). Ju ftojë ta miratoni nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Cila është arsyeja e heqjes së huamarrjes nga kodi buxhetor, sa ka qenë shuma?

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Në vitin 2022 nga huamarrja janë shpenzuar 308.363 euro, ndërsa në vitin 2023 nuk kemi pas shpenzime dhe as në vitin 2024. Total Buxheti për vitin 2023 janë shpenzuar në përqindje 95.62 %.

znj.Adelina Beqaj; Te zyra e Kryetarit janë shpenzuar gati 100%, a keni pasqyrë financiare se si janë shpenzuar këto mjete? Dhe dy sa është shuma e mjeteve (vlera) që kanë shkuar në suficit?

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Mbetje te pagat nuk ka. Te mallrat dhe shërbime kur ti kemi të përfunduara atëherë mund ta dimë me saktësi për secilën kategori sa kanë qenë të planifikuara dhe sa janë shpenzuar.

z.Përparim Ramusa; Në mbledhjen e Kuvendit, Kimete duhet ta dimë dhe ta diskutojmë për secilen kategori veq e veq. Unë mendoj se shpenzimet nuk kanë qenë reale. Po flasë për dy projekte. Tregu dhe rruga Godanc-Gjyrkovc. Rritja e të hyrave nuk është reale, sepse janë rritë shpenzimet. Te një projekt me Komunën dhe me shoqatën "Katari" pse nuk është realizuar, kur e dimë se projekti i njejt është realizuar në Ferizaj. Nëse mundet dikush me mu përgjigjë për këtë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje, e dimë që vlera e tatimit është rritë, është e vërtetë. Mirëpo kur dalim në fund me tabelat përfundimtare do ta shohim pse, edhe pse gjithmonë ka mundësi për më mirë.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, faleminderit Kimete për raportin. U thanë disa gjëra për rritjen e të hyrave që është për ta verësuar, po ashtu është për ta vlerësuar shpenzimin e buxhetit nga Komuna jonë, sepse ka Komunë që janë me 60% të shpenzimit të buxhetit. Pajtohem me Adelinën që na nevojiten të dhëna shtesë për pasqyrat e shpenzimeve. Kam mendim pozitiv për shpenzimin e buxhetit, dhe do ta votoj këtë raport.

znj.Kimete Ukaj; Për këtë vit na bjen mjaft shumë me bartë mjete sepse vitin e kaluar 2023 është rritë kufiri i të hyrave mjaft shumë në krahasim me vitin 2022.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje te Shpenzimet Kapitale ndoshta na tregon drejtori i Urbanizmit. Ju e keni kry punën e juaj edhe pse unë kam disa dyshime se diçka nuk është realizuar, por është paguar. Te pjesa e planifikimit pse po bëhet më i ulët?

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Përshëndetje, pajtohem që raporti duhet me qenë i ndarë saktësisht. Raporti është i dokumentuar prej A deri në ZH. Për disa pyetje të Përparimit për Tregun dhe rrugën Godanc-Gjyrvokc, janë shkëputur kontratat për shkakë se operatori ekonomik ka qenë i papërgjegjshëm dhe nuk kemi mujt me punu me operator të papërgjegjshëm. Te OJQ “Katarit” ne nuk kemi mujtë me paguar “Katarin” sepse kemi pas rekomandim nga Thesari. Tatimi është dallim vetëm për 54 mijë euro, te lejet ndërtimore kemi rritje rreth 120 mijë euro. Asnjë pagesë nuk është kryer pa u kryer punët në teren, e them me përgjegjësi të plotë.

znj.Adelina Beqaj; A mundesh me siguru një dokument mbi kriteret për asfaltimin e rrugës. Kërkojë haptas raportin për shpenzimet e zyrës së Kryetarit.

z.Përparim Ramusa; Me qfarë logjike keni marrëveshje me shoqatën “Jetimat e Ballkanit”. Dhe tjetra tregu ka pas me u përfundu në vitin 2022 dhe humbje kemi në kohë. Unë jam “kundër” këtijë raporti dhe nuk do të diskutojë më.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Te shoqata “Jetimat e Ballkanit” pagesat shkojnë përmes subvencioneve dhe asnjë pagesë nuk është bërë deri tash.

znj.Kimete Ukaj; Te pjesa që ta bëjmë pagesën sa i përket “Katarit” ne sipas tyre është dashtë me ja paguar pjesën tonë të mjeteve financiare pa e filluar punën fare. Te OJQ “Jetimat e Ballkanit” pagesat shkojnë përmes subvencioneve.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit Vjetor Buxhetor për vitin 2023.**

Pika 4

Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bardhyl Rushitit.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshëndetje, sipas vendimit të Kuvendit kemi mbajtur diskutimin publik dhe kemi pas disa propozime. Në vazhdim lexoi këto propozime (shih dokumentin). Ju ftoj që ta votoni nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Kadri Emini; Unë mendoj se kjo rregullore duhet me pasë disa ndryshime te orari i gastronomisë p.sh te objektet ku ka banorë duhet të kufizohet orari i punës për dallim p.sh te Aqua Parku edhe mund të lejohet sepse nuk e pengon askend. Ku ka banime mos me u leju me punu pas orës 22:00h dimrit dhe pas orës 23:00h verës.

z.Përparim Ramusa; Jeni pak konfuz, Ligji i pnës e rregullon punën, jemi dakord që me u mbrojtë punëtorër, por edhe për familjarët unë jamë dakord me propozimin e Kadriut. Kërkojë një listë të bizneseve që kanë bërë petition ta kemi në mbledhjen e Kuvendit.

znj.Adelina Beqa; Po e shohë një mungesë të vullnetit të drejtorit sepse kemi një kërkesë të 30 familjeve sipas kërkesës që ka bërë Nderim Hysiqi.

z.Lumni Amrushi; Propozimin e Kadriut e mbështes. Te na bizneset funksionojnë në kundërshtim me ligjin. Te banimet kolektive të merret parsysh qështja e zhurmës. Lojrat e fatit sa e di unë nuk kanë mundësi të funksionojnë brenda 400 metrave. Në fshatra i kanë mbyllë brenda kësaj distance para 4 viteve.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje, pajtohem që të kemi orarin e bizneseve mirëpo kërkesa e Nderimit ka ardhur me 26.01.2024. Unë jam për me rregullu këtë çështje sepse po kemi pengesa për zhurmën që po bëhet. Le të jetë hera e parë që më ndërhysh dikush në fjalën time, sepse unë askujt nuk po i ndërhy.

z.Përparim Ramusa; Kërkesa e e qytetarit është e ligjëshme sepse ka ardhur para mbledhjes. E përkrahu propozimin e Kadriut por ne kemi edhe çështje të tjera për me i diskutuar dhe deri në Kuvend ne do të abstenojmë.

znj.Adelina Beqaj; Drejtori duhet me i përmbledhëtë gjitha propozimet dhe duhet me ardhë në Kuvend me rekomandim.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Draft-Rregullores për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes, me rekomandimin që Drejtori i DSHP-së me i përmbledhë të gjitha propozimet me një rekomandim dhe me i paraqitë në Kuvend për shqyrtim më dt. 31.01.2024.**

Pika 5

Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që nuk kishte diskutime Kryesuesi Konstatoi Kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren Komunale për Transparencë. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit dhe Zyra për Informim.**

Pika 6

Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që nuk kishte diskutime Kryesuesi Konstatoi Kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Planin e veprimit për transparencë komunale 2024-2028. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit dhe Zyra për Informim.**

Pika 7

Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Propozojë të na japin më shumë sqarime në Kuvend dikush nga ekzekutivi. Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që nuk kishte diskutime Kryesuesi Konstatoi Kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit, me rekomandimin që në mbledhjen e Kuvendit më 31.01.2024, ekzekutivi të sqaroi saktësisht këtë propozim.**

Pika 8

Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që nuk kishte diskutime Kryesuesi Konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Programit Strategjik për Ujërat në Komunën e Shtimes, me rekomandimin që kjo pikë të sqarohet në Kuvend më 31.01.2024, nga ekzekutivi, lidhur me propozimet nga diskutimi publik.**

Pika 9

Propozim-Vendim për ndarjen e subvenc. për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Ne e përkrahim këtë propozim-vendim për nënat lehona, por shumicën do ta diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po kërkojmë nga ekzekutivi që propozimet për shifrat konkrete të na i sjellin në Kuvend.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e subvencioneve për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024.**

Pika 10

Propozim-Vendim për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërrmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Unë jam për ta hapur këtë mundësi por ka shumë të panjohura.

znj.Adelina Beqaj; Sa e di unë e kemi një vendim të Kuvendit për Kryetarin për këtë çështje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Të sillet në Kuvend vendimi paraparak i Kuvendit dhe ta diskutojmë edhe këtë vendim nëse ka nevojë ta shfuqizojmë ose ndryshojmë. Në vazhdim Kryesuesi, Konstoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërrmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes. Me rekomandimin që për mbledhjen e Kuvendit më 31.01.2024 të përcillet me E-mail anëtarëve të Kuvendit vendimi i mëparshëm i Kuvendit me të cilin është autorizuar Kryetari për një qështje të tillë.**

Pika 11

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, lexoi propozim-vendimin.

z.Përparim Ramusa; Propozojë që të miratohet ashtu siq ka ardhur propozimi.

*** Komitetit për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e -I- për vitin 2024, e mbajtur më: 29.01.2024, unanimsisht miratoi vendimin për caktimin e orarit e mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2024.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 11:46h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

